



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:007761  
Datë: 26.09.2024  
Numri i dokumentit: 06211333

**APS.nr.38/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani – kryetar i kolegjit, Vaton Derguti dhe Afërdita Bytyqi – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në lëndën penale ndaj të akuzuarve Dh.H. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPRK-së. F.M. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së, D.Sh. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së, K.C. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 2 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së dhe N.O. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.04/2021 të datës 27 korrik 2023, të ushtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Special PS.nr.31/21 të datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.31/21 i datës 28.04.2023, **VËRTETOHET**.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me aktgjykimin PS.nr.31/21 të datës 28.04.2023 të akuzuarit Dh.H., F.M., D.Sh., K.C. dhe N.O., konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së i ka liruar nga akuzua për veprat penale të akuzuara përmes aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.04/2021 të dt. 07.07.2021.

E dëmtuara Qeveria e Kosovës për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civilo-juridik, ndërkaq shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tersi ankesën si të bazuar kurse aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të pandehurit t'i dënojë sipas ligjit ose ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit D.Sh., av. A.Rr., me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorit të shtetit ndërsa të vërtetohet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit N.O., av. H.S., me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorit të shtetit si e pabazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit K.C., av. A.K., me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorit të shtetit ndërsa të vërtetohet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.483/2023 të datës 07.09.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ndërsa të akuzuarit të dënohen sipas ligjit ose aktgjykimin i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim

dhe rivendosje, ndërsa të refuzohen si të pabazuara përgjigjet në ankesë të parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve D.Sh., av. A.Rr., N.O., av. H.S. dhe K.C., av. A.K..

Gjykata e Apelit konform nenit 390 të KPP-së, me datë 08.04.2024 ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Prokurorisë së Apelit, A.B., i cili mbeti në tersi pranë parashtrësës që ka parashtruar Prokuroria e Apelit, me propozimin që ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës të aprovohet si e bazuar, ndërsa të akuzuarit të dënohen sipas ligjit ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, av. F.L., i akuzuari F.M., av. M.G., av. T.Rr., av. A.K., i akuzuari N.O. dhe av. H.S., të cilët mbetën pranë përgjigjeve në ankesë dhe e kundërshtuan në tërësi ankesën e Prokurorisë, ndërsa nuk kanë prezantuar të akuzuarit, Dh.H., D.Sh. e K.C., si dhe nuk ka prezantuar asnjë përfaqësues i palës së dëmtuar (Qeveria e Kosovës) edhe pse të njëjtit kanë qenë të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se: **Ankesa nuk është e bazuar.**

### **Pretendimet ankimore**

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës theksohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke vepruar në kundërshtim me nenin 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2 pika 2.4 të KPP-së, pasi që sipas prokurorisë aktgjykimin të ankimuar i mungon arsyetimi i plotë në kuptim të nenit 384 par.1 pika 1.10 e KPP-së. Sipas ankesës së prokurorisë, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar provat e propozuara nga prokuroria apo edhe të pandehurve por vetëm i ka renditur ato sikurse në faqe 20 dhe 21 të aktgjykimin të ankimuar, por në asnjë formë nuk ka bërë vlerësimin apo analizën e tyre. Madje, sipas prokurorisë gjykata as nuk ka treguar nëse ua kishte falur besimin të njëjtave ose ti komentojë nëse e provojnë teorinë e akuzës apo teorinë e mbrojtjes. Prokurori përmes ankesës pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar mbi 70 për qind të provave, prova këto të cilat sipas prokurorisë e dëshmojnë inkriminimin e të pandehurve dhe e pasqyrojnë dashjen dhe dijeninë e të pandehurve për të kryer veprimet kriminale. Kësisoj, prokuroria thekson se gjykata e shkallës së parë është në kundërshtim me nenin 384 par.2 pika 2.4 të KPP-së, njëherit kjo sipas prokurorisë edhe shkelja kryesore e gjykatës në këtë rasti pasi që kjo ndikon drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktgjykimin të gabuar pasi që nuk është gjykuar në mënyrë të plotë

substancia e akuzës. Në ankesë, prokuroria ka paraqitur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë në raport me të pandehurën Dh.H., ku sipas prokurorisë, gjykata e ka gjykuar të pandehurën vetëm në raport me pikën I të dispozitivit të aktakuzës edhe pse në aktakuzës veprimet e saj inkriminuese ishin renditur në tri pika, duke anashkaluar kështu dy pikat tjera veçanërisht pikën III ku aty tregohet qartazi dashja e të pandehurës për t'ia mundësuar përfitimin dy kompanive të cilat i kishte përzgjedhur në mënyrë arbitrare vetë ajo duke i nënshkruar kontratat. Sipas prokurorisë, gjykata duke mos ndëshkuar veprimet e të pandehurës veçanërisht të Dh.H. jo vetëm që pa ndëshkuar të pandehurit por vë në pikëpyetje edhe nevojën e zbatimit të Ligjit të Prokurimit Publik duke krijuar kështu një praktikë të dëmshme që në të ardhmen të bëhen tejkalimet e kompetencave të këtij ligji. Prokurori pretendon se gjykata nuk e ka gjykuar në mënyrë të plotë substancën e akuzës duke marrë parasysh konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se e pandehura Dh.H. nuk kishte tejkaluar çështjen e arritjes së objektivave të kontratave pasi që sipas gjykatës kjo ishte përgjegjësi politike dhe jo në kompetencat e të pandehurës. Po ashtu, prokuroria thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh ekspertizën e ekspertit A.Sh. dhe dëshmitë e dëshmitarëve ku është pasqyruar dëmi financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe përfitimin që kishin realizuar kompanitë e përcaktuara nga Dh.H., si dhe faktin se kompanitë që ishin përzgjedhur nuk ofronin shërbimet e nevojshme dhe se e pandehura nuk kishte kërkuar asnjëherë llogari për mosarritjen e objektivave. Fakti se MIE nuk kishte nevojë për shërbimet e ofruara nga kompanitë që kishin lidhur kontratë me Dh.H. vërtetohet nga provat e dorëzuara me anë të parashtrësës së datës 07.12.2022, por sipas prokurorisë këto prova nuk janë trajtuar fare nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, sipas prokurorisë një fakt i tillë vërtetohet edhe nga e-maili i dërguar nga dëshmitari V.J. i datës 09.01.2020 për të pandehurin K.C., ku vërtetohet se dëshmitari V.J. e njofton të pandehurin K.C., me vendimin që kishin marrë si komision për refuzim të pranimit të shërbimeve për shkak se faturat e dorëzuara nga kompania "M.... P.. & E....", ishin identike dhe gjithmonë ishte faturuar i njëjti shërbim (monitorimi i mediave), ashtu sikurse kishte konstatuar edhe eksperti A.Sh.. Sipas prokurorisë përmes këtij emaili vërtetohet se dëshmitari e njofton të pandehurin se mund të kërkonte përgjegjësi ose llogari nga kompania për mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale por pavarësisht informimit nuk ishte marrë asnjë masë, duke vënë në pah kështu edhe njëherë qëllimin e të pandehurës për t'ia mundësuar përfitimin kompanive në fjalë. Kësisoj, prokuroria thekson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim ose ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale përkatësisht të nenit 384 par.1, pika 1.2 dhe par.2 pika 2.1 të KPP-së ngase është gjykuar vetëm njëra pikë e aktakuzës dhe dy pikat tjera si në dispozitiv të aktakuzës nuk janë gjykuar fare, po ashtu mbi 70 për qind të provave nuk janë

komentuar fare. Shkeljet e gjykatës së shkallës së parë sipas prokurorisë vërtetohen edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 21.12.2022 në të cilin prokurori i kësaj çështje kishte theksuar se nuk do ta nënshkruante procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor paraprak atë të datës 12.12.2022 me arsyetimin se ai procesverbal kishte gabime në konstatimin e profesionit të ekspertit dhe në konstatimin e pyetjeve edhe përgjigjeve që i parashtroheshin atij të meta këto që sado që mund të supozohet se ishin të karakterit teknik apo drejtshkrimor, ngjallin frikën se gabime të tilla mund të jenë lëshuar edhe në pjesë tjera të procesverbaleve të cilat nuk janë evidentuar për shkak se ishin voluminoze dhe ishin dërguar me vonesë - disa ditë pas përfundimit të seancave apo në kundërshtim me dispozitat e KPP-së. Prokuroria pretendon se një gjë e tillë mund të jetë bërë ose duhet të ketë frikë se kjo ka ndodhur për të dëmtuar reputacionin apo kredibilitetin e ekspertit të prokurimit dhe se një veprim i tillë sipas prokurorisë ishte tendencë e mbrojtjes, përkatësisht gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.11.2022. Po ashtu, sipas prokurorisë, gjykata ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale përkatësisht nenit 384 par.2 pika 2.1 edhe në rastin kur gabimisht ka ftuar dëshmitarë për të dhënë dëshminë e tyre duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në rrjedhën e procedurës dhe favorizimin e të pandehurve. Sipas prokurorisë, gjykata nuk ishte efikase pasi në disa seanca ku ishte prezent dëshmitari V.J. dhe duke qenë e informuar se i njëjti kishte për të udhëtuar jashtë vendit, kishte vendosur që në vend të tij ta dëgjoj ekspertin, siç është seanca e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.12.2022 ku e kishte larguar dëshmitarin V.J. nga salla dhe e kishte ftuar ekspertin për ta dëgjuar dhe në vend se të njëjtin ta dëgjoj deri në fund kryetari i trupit gjykues e kishte ndërprerë seancën pas marrjes në pyetje nga prokuroria me arsyetimin se seanca nuk mund të vazhdoj për shkak se anëtarët e trupit gjykues kishin një seancë tjetër për paraburgim duke e shtyrë kështu seancën për datën 21.12.2022 dhe duke i mundësuar kështu mbrojtjes përgatitjen për marrjen e tërthortë në pyetje të ekspertit. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.12.2022 përsëri është larguar dëshmitari V.J. dhe kishte vazhduar marrja në pyetje e ekspertit A.Sh. siç mund të shihet në faqen 95 të këtij procesverbali dhe gjatë sesionit të pasdites dëshmitarit V.J. përsëri i ishte kërkuar që ta lirojë sallën dhe i njëjti të paraqitej një ditë tjetër, i cili më pas kishte reaguar duke deklaruar se po mall tretohej nga gjykata për shkak të mos menaxhimit të duhur të seancës pasi që i njëjti ishte ftuar dy herë në seancë dhe ishte nxjerrë jashtë nga ajo në temperatura të ulëta. Kështu, prokuroria pretendon se gjykata kishte vepruar gabimisht që nga fillimi pas që të njëjtit kishin qenë të informuar se ai do të udhëtonte jashtë vendit dhe ishte propozim i prokurorisë që fillimisht të intervistohet dëshmitari, teksa gjykata përsëri vendosi që ta ndërpresë në gjysmë marrjen në pyetje të ekspertit A.Sh. dhe seanca të vazhdoj me marrjen në pyetje të dëshmitarit V.J., duke favorizuar kështu mbrojtjen dhe duke ia humbur relevancën dëshmisë së ekspertit

A.Sh. dhe dëshmisë së dëshmitarit V.J.. Sipas prokurorisë kredibiliteti i gjykatës ishte ulur gjatë konfrontimit të kryetarit të trupit gjykues me dëshmitarin dhe se pastaj nuk mund të pritët që ti falet besimi apo të vlerësohet në mënyrë të drejtë deklarata e dëshmitarit. (Konfrontimi mes kryetarit të trupit gjykues e dëshmitarit mund të shihet në këtë link nga minuta 10:35, <https://www.....>). Sipas prokurorisë, gjykata ka zbatuar gabimisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për faktin se seancat i ka caktuar gabimisht apo në lloj diference kohore prej rreth 60 ditësh duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 310 të KPP-së duke ndikuar kështu në efikasitetin e gjykimit. Po ashtu prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ishte objektive për faktin se vendimet e saj të marra gjatë seancave lidhur me propozimet e prokurorit ishte në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe se të njëjtat ishin revokuar pas konsultimeve me prokurorin siç shihet edhe në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 07.04.2023 faqe 136, ku gjykata nuk ka marrë mundin të analizoj ose vlerësoj provat e administruara nga prokurori. Sipas prokurorisë anshmëria e gjykatës dëshmohej edhe nga mënyra e trajtimit apo interpretimit të provave dhe deklaratave të dëshmitarëve të përshkruara në aktgjykim duke ia humbur thelbin deklaratës dhe duke e interpretuar atë në favor të të pandehurve, pasi që të njëjtat duket se janë përshkruar në atë mënyrë që të krijojnë përshtypjen se dëshmitarët nuk kanë deklaruar asnjë veprim inkriminues për të pandehurit. Si shembull prokuroria ka paraqitur deklaratën e dëshmitarit O.B. pasi që deklarata e tij vetëm se është përshkruar pjesërisht në aktgjykim dhe nuk është vlerësuar fare teksa gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.10.2022 faqe 65 i njëjti kishte theksuar se Autoriteti Kontraktues kishte për obligim që të bënte hulumtimin e tregut para se të hynte në negociata me qëllim të hulumtimit të disa faktorëve, pjesë kjo e cila nuk është përshkruar fare në aktgjykim, e që sipas prokurorisë kjo pjesë dëshmon dashjen e të pandehurit për t'ia mundësuar përfitimin kompanive me të cilat kishin lidhur kontratat sepse nëse do të bëhej hulumtimi i tregut do të kuptohej çmimi i rregullt, numri i kompanive që ofrojnë shërbimet e kërkuara etj. Po ashtu sipas prokurorisë në aktgjykim mungon edhe pjesa tjetër e deklaratës së dëshmitarit O.B. si në faqe 63 të procesverbalit të së njëjtës ditë ku flitet lidhur me vazhdimin e kontratës e cila sipas dëshmitarit lejohet vetëm për 10 për qind, ndërsa në rastet e jashtëzakonshme si në rastin konkret autoriteti nuk mund të lihet në asnjë rrethanë që sërish të aplikojnë procedura të jashtëzakonshme sikurse kishte ndodhur në rastin konkretë, duke shfaqur edhe njëherë tjetër dashjen e të pandehurve për të nënshkruar kontratat me kompanitë e lartcekura pa negociuar. Sipas prokurorisë, anshmëria e gjykatës në këtë rast mund të vërtetohet edhe përmes deklaratës së dëshmitarit V. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 17.06.2022, ku i njëjti kishte deklaruar se ai dhe anëtarët e komisionit nuk e kishin nënshkruar procesverbalin për pranimin e

shërbimeve për arsye se shërbimet e kryera nuk korrespondojnë me kontratën dhe një fakt i tillë vërtetohet edhe nga procesverbali i dorëzuar si provë nga prokuroria, ndërkaq që sipas prokurorisë gjatë kësaj seance kryetari i trupit gjykues kishte parashtruar një pyetje ndaj dëshmitarit e cila nuk do të duhej t'i parashtrohej. Prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ishte objektive dhe se një gjë e tillë ishte shfaqur qysh në fazat e hershme të shqyrtimit gjyqësor me shkas edhe kishin paraqitur kërkesën për përjashtimin e kryetarit të trupit gjykues pasi që i njëjti nuk e ka menaxhuar gjykimin konform dispozitave të KPP-së.

Përpos shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Prokuroria Speciale aktgjykimin e ankimuar e atakon edhe për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, me pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrën e duhur provat e paraqitura nga prokuroria. Sipas ankesës, gjykata ka analizuar vetëm dy prova në këtë rast siç është opinionimi i KRPP-së dhe ekspertizën e ekspertit A.Sh., ndërkaq ka anashkaluar 18 provat e tjera të paraqitura nga ana e prokurorisë, pasi që sipas prokurorisë fillimisht ata kanë dorëzuar 15 prova me aktakuzë dhe 5 prova të tjera i kanë dorëzuar me parashtrësë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Sipas prokurorisë gjykata i ka anashkaluar në tërësi provat e tjera e në veçanti ka anashkaluar provat siç është kërkesa e parashtruar nga e pandehura Dh.H. me nr. prot.0./8....-2..., datë 11.05.2018, për të pandehurin D.Sh.. me anë të së cilës vërtetohet se e njëjta përveç se e kishte iniciuar procedurën e prokurimit e përcakton edhe Ilojin e procedurës së prokurimit (e negociuar apo sipas nenit 35 të LPP-së), si dhe e përcakton emrin e kompanisë "M..... P.. & E....." dhe urdhëron lidhjen e kontratës me kompaninë "M..... P.. & E.....". Po ashtu ka anashkaluar kërkesën e parashtruar nga e pandehura Dh.H., me nr. prot.0./2...-2..., datë 21.02.2019, për të pandehurin K.C., ku ngjashëm e njëjta kërkon që sipas procedurave të sipër cekura t'i vazhdohet kontrata kompanisë "M..... P.. & E.....", si dhe kërkesën e parashtruar po ashtu nga e pandehura Dh.H. me nr. prot. 6...-2..., datë 24.04.2019, për të pandehurin K.C., ku ngjashëm e njëjta kërkon që të lidhet kontratë me kompaninë "M..... G.....". Prokuroria pretendon se gjykata ka anashkaluar edhe provat tjera të paraqitura nga ana e prokurorisë si në aktakuzë dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, madje sipas tyre edhe provat të cilat i ka analizuar nuk i ka analizuar apo vlerësuar në mënyrën e duhur pasi vetëm i ka përshkruar ato. Sipas ankesës së prokurorit special, gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar kontratat me titull "Shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së", kontratat me kompaninë "M..... P.. & E.....", dhe një me kompaninë "M..... G.....", nga të cilat sipas prokurorisë vërtetohet se e pandehura i kishte nënshkruar kontratat me kompanitë e lartcekura të cilat vetë i kishte përzgjedhur në mënyrë

arbitrare. Sipas ankesës së prokurorisë, gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar asnjërin nga këto konstatimin e ekspertit si në faqe 12 par.1, konstatimin e ekspertit si në paragrafin 4 të faqes 12, deklaratën e ekspertit në shqyrtim gjyqësor si në faqen 78 të procesverbalit, pjesën e deklaratës së ekspertit si në faqen 93 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 21.12.2022, përgjigjen e ekspertit si në faqen 94 të të njëjtit procesverbal. Po ashtu sipas prokurorisë, gjykata nuk e ka analizuar as deklaratën e dëshmitarit N.N. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor si në procesverbalin e datës 17.06.2023, faqe 32 dhe 33. Gjithashtu sipas prokurorisë, gjykata nuk e ka vlerësuar dhe analizuar as deklaratën e dëshmitarit N.N. dhe deklaratën e të pandehurit K.C. a si dhe provat tjera materiale nga të cilat sipas prokurorisë vërtetohet se Ministria e Integritetit Evropian, pas përfundimit të mandatit të të pandehurës Dh.H., me urdhëresë të saj kishte shkëputur kontrata në mënyrë të njëanshme me kompaninë "M..... G.....", prova këto që sipas prokurorisë drejtpërdrejt tregojnë dashjen e të pandehurës për t' i mundësuar përfitim kësaj kompanie, në të kundërtën nëse shërbimet do të ishin në interes të vendit nuk kishte arsye për ta shkëputur kontratën në mënyrë të njëanshme, e cila për t'u lidhur ishte dashur që të përdorej një procedurë e jashtëzakonshme sikurse është procedura e negociuar sipas nenit 35 të LPP-së, e aplikuar në rastin konkret. Po ashtu, prokurori pretendon se gjykata nuk e ka vlerësuar as provën siç është "Opinionit i Departamentit të Drejtësisë të BE-së", e as kontratën me titull "Shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së". me nr. të prokurimit 2. -.-.-.../..., datë 17.06.2019, por edhe nga prova shtesë e dorëzuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor datë 08.02.2023, faqe 121. Po ashtu sipas prokurorisë, gjykata përveç se i ka vlerësuar gabimisht deklaratat e dëshmitarëve dy prej tyre nuk i ka analizuar fare, sikurse janë deklaratat e O.B. dhe N.N.. Prokurori në ankesën e tij gjithashtu shton se gjykata në arsyetimin e saj gabimisht i është referuar edhe opinionit të KRPP-së, duke theksuar se sipas këtij opinionit KRPP i kishte dhënë "shumë diskrecion AK-së që të vendos lidhur me procedurën e cila do të zgjidhet".

Prokurori në ankesën e tij shton se gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve V.H., B.V.C, V.H. dhe V.J., nuk i ka kuptuar relevancën e tyre ose të njëjtat i ka interpretuar në favor drejtpërdrejt të të pandehurve, pasi që këto dëshmi drejtpërdrejt vërtetojnë që këto kontrata të lidhura në mes të Ministrisë së Integritetit Evropian me kompanitë " M..... P.. & E....." dhe "M..... G.....", nuk janë implementuar ashtu sikurse parashihej në kushtet e kontratës. Sipas ankesës së prokurorisë, gjykata nuk ka komentuar e as vlerësuar as provën siç është "Vendimi i Komisionit disiplinor për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues", nr. prot. 5.../., dt. 22.05.2020, e as nuk e ka analizuar tejkalimin e kompetencës në aspektin gjeografik



nga Ministria e Integritimit Evropian me rastin e hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me një kompani nga ShBA-ja, pasi që MIE nuk kishte kompetenca territoriale jashtë territorit të vendeve të Bashkimit Evropian. Sipas prokurorisë, gjykata në arsyetimin e saj gabimisht ka konstatuar se nuk është vërtetuar qëllimi kriminal i të pandehurve për kryerjen e veprës penale dhe se një rrethanë e tillë që vërteton dashjen e të pandehurve veçanërisht janë opinionet që i janë dhënë të pandehurve në veçanti ai i Departamentit të Drejtësisë të BE-së, dt. 25.05.2018. i cili qartazi ia kishte sqaruar të pandehurve kompetencat e tyre personale si bartës të funksioneve, kompetencat e Ministrisë së Integritimit Evropian, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës së Kryeministrit, si dhe iu kishte rekomanduar procedura tjera alternative më transparente për t'i aplikuar, të cilat të pandehurit i injoruan.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, e sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, nga fakti se dispozitivi është i qartë dhe në përputhje me arsyetimin e tij në të cilin janë paraqitur arsyet e plota dhe të qarta për fakteve vendimtare dhe zgjidhjes së çështjeve juridike të kësaj çështje penale dhe se nuk përmban asnjë shkelje tjetër e cila kishte për të kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjyimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar provat e propozuara nga prokuroria apo edhe të pandehurve por vetëm i ka renditur ato, sikurse në faqe 20 dhe 21 të aktgjyimit të ankimuar, por në asnjë formë nuk ka bërë vlerësimin apo analizën e tyre, dhe që gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar mbi 70 për qind të provave, prova këto të cilat sipas prokurorisë e dëshmojnë inkriminimin e të pandehurve dhe e pasqyrojnë dashjen dhe dijeninë e të pandehurve për të kryer veprimet kriminale. Kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjyimit të ankimuar rezulton qartazi se gjykata e shkallës së parë, në faqe 20-21 të pretenduara si në ankesë, kishte paraqitur/përshkruar provat të cilat janë administruara në shqyrtim gjyqësor dhe që në raport me këto provat në pjesën e gjetjeve të gjykatës nga fq.27, kishte dhënë vlerësimin mbi analizimin e këtyre e këtyre provave për të ardhur në përfundim nëse në veprimet e të pandehurve manifestohen elementet e veprës penale andaj, pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësua mbi 70% të provave, sipas vlerësimit të këtij kolegji penal të jetë i pabazuar pasi që ashtu si paraqitet në pretendim

ankimore me përqindje (70%) nuk mund të kuptohet qartazi për tu analizuar saktësisht se cilat provat nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ngase në këtë mënyrë pretendim ankimor rezulton abstrakt për qëllimet e vlerësimit të pretendimit ankimor në raport me aktgjykimin e ankimuar, ndërsa në anën tjetër me përfundimin e gjykata e shkallës së parë pajtohet edhe kjo gjykatë, ngase nga provat e administruara, si në shkresat e lëndës, prokuroria nuk kishte ofruar provat me të cilat kishin për tu vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të akuzuarve përbushen elementet e veprës penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, pra sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e së shkallës së parë ka dhënë arsyet e qarta dhe konkrete me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimore se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me nenin 384 par.2 pika 2.4 të KPP-së, njëherë edhe shkelja kryesore e gjykatës në këtë rast pasi që kjo ndikon drejtpërdrejt në nxjerrën e aktgjykimit të gabuar pasi që nuk është gjykuar në mënyrë të plotë substanca e akuzës, në raport me të pandehurën Dh.H., ku sipas prokurorisë gjykata e ka gjykuar të pandehurën vetëm në raport me pikën I të dispozitivit të aktakuzës edhe pse në aktakuzës veprimet e saj inkriminuese ishin renditur në tri pika duke anashkaluar kështu dy pikat tjera veçanërisht pikën III ku aty tregohet qartazi dashja e të pandehurës për t'ia mundësuar përfitimin dy kompanive të cilat i kishte përzgjedhur në mënyrë arbitrare vetë ajo duke i nënshkruar kontratat. Kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet të qarta dhe të plota përkitazi me objektin e akuzës, pra për veprimet të cilat i janë vënë në barrë me akuzë gjegjësisht **tejkalimit të kompetencave të saj** si ministre me qëllim të mundësimit të përfitimit të dobisë pasurore personit tjetër, OE “M..... P.. & E.....” dhe “M..... G..... S..... LLC”, për pikën pretenduese III të dispozitivit të akuzës andaj, në këtë drejtim nuk qëndron pretendimi ankimor se nuk është gjykuar në mënyrë të plotë substanca e aktakuzës, pasi që edhe për pikën III gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet se pse kishte ardhur në përfundim për të liruar nga akuzua të akuzuarën Dh.H. por edhe të akuzuarit të tjerë në këtë çështje penale, pasi që me provat e proceduara në shqyrtim gjyqësore nuk janë provuar faktet konkrete të cilat përbëjnë elementet kryesore të figurës së veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit nga prokuroria speciale, të cilën përfundim për arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë pajtohet dhe kjo gjykatë si përfundim të drejtë dhe ligjor.

Andaj, në këtë drejtim edhe pretendimi ankimore se gjykata nuk e ka gjykuar në mënyrë të plotë substancën e akuzës, duke marrë parasysh konstatimet e gjykatës së shkallës së parë se e pandehura Dh.H. nuk kishte tejkalluar çështjen e arritjes së objektivave të kontratave pasi që sipas gjykatës kjo ishte përgjegjësi politike dhe jo në kompetencat e të pandehurës, është pretendim i pabazuar për faktin se nga arsyet të cekura si më lartë, rrjedh padyshim se kjo çështje penale është gjykuar në mënyrë të plotë në raport me substancën e aktakuzës e jo si pretendon prokuroria me ankesën e saj.

Gjykata e Apelit, përkitazi me çështjen e ngritur si në pretendimin ankimor për mos gjykimin në mënyrë të plotë të substancës së akuzës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka zgjidhur në tërësi substancën e akuzës, kjo pasi që në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar gjykata ka përfshirë tërësinë e përshkrimit faktik si në aktakuzë për veprën penale për të cilën të akuzuarit i ka liruar nga akuza.

Do të ishte krejtësisht ndryshe situata, nëse në dispozitiv të aktgjykimit gjykata nuk do të përfshinte veprën-përshkrimin faktik përkatës, për të cilën do ta kishte liruar pra mos gjykuar këtë përshkrim ndërsa për përshkrimet tjera-veprat tjera që përbëjnë tërësinë e veprës penale të vazhduar do ti shpallte fajtor atëherë do të kishte ardhur në shprehje mos zgjidhja në tërësi të lëndës së akuzës, gjë që në këtë rast është krejtësisht ndryshe dhe e qartë se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar e ka gjykuar në tërësi substancë e akuzues pasi që në dispozitiv të saj ka përfshirë edhe veprën- përshkrimin faktik (III) së bashku me përshkrimet faktike tjera (pika I dhe II) të cilat përbëjnë tërësinë e veprës penale në vazhdim për të cilën vepër penale gjykata i ka liruar nga akuza pra, për të gjitha veprat si pikat e përshkrimet faktike si në aktakuzën e PSRK-së gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar i kishte zgjidhur vendosur gjë që rrjedh qartazi nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimore se, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh ekspertizën e ekspertit A.Sh. dhe dëshmitë e dëshmitarëve ku është pasqyruar dëmi financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe përfitimin që kishin realizuar kompanitë e përcaktuara nga Dh.H. si dhe faktin se kompanitë që ishin përzgjedhur nuk ofronin shërbimet e nevojshme dhe se e pandehura nuk kishte kërkuar asnjëherë llogari për mosarritjen e objektivave. Kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, fq.30, rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka analizuar ekspertizën e ekspertit A.Sh. dhe në këtë drejtim ka dhënë arsyetimin, për të cilin qëndrim pajtohet dhe kjo Gjykatë, ngase ashtu si kishte paraqitur eksperti

*se procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontrata, në këtë kuadër edhe shkelja e të drejtave të konkurrentëve të tjerë **potencial** në këtë aktivitet të prokurimit dhe shkaktimit të dëmit për ata apo këdo tjetër është abstrakt dhe i pakuptimit dhe se mos përmbushja e pozicioneve që kanë qenë objekt i kësaj kontrate, dhe sipas gjetjeve të ekspertit se nuk është përmbushur në tërësi objekti i kontratës, me paraqitje të vërejtjeve të përshkimit të shërbimit, i cili është paguar nga MIE, këto çështje mbesin në sferë administrative apo të marrëdhënies së detyrimeve dhe këto si të tilla nuk përmbajnë asgjë për të vërtetuar elemente e veprës penale për të cilën janë akuzuar.*

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimore se MIE nuk kishte nevojë për shërbimet e ofruara nga kompanitë që kishin lidhur kontratë me këtu të pandehurën, DH.H., e që kjo vërtetohet nga provat e dorëzuara me anë të parashtrësës së datës 07.12.2022, por sipas prokurorisë këto prova nuk janë trajtuar fare nga gjykata e shkallës së parë, e një fakt i tillë vërtetohet edhe nga email-i i dërguar nga dëshmitari V.J. i datës 09.01.2020 për të pandehurin K.C., ku vërtetohet se dëshmitari V.J. e njofton të pandehurin K.C., me vendimin që kishin marrë si komision për refuzim të pranimit të shërbimeve për shkak se faturat e dorëzuara nga kompania " M..... P.. & E.....", ishin identike dhe gjithmonë ishte faturuar i njëjti shërbim (monitorimi i mediave), ashtu sikurse kishte konstatuar edhe eksperti A.Sh., që sipas prokurorisë përmes këtij email-i vërtetohet se dëshmitari e njofton të pandehurin se mund të kërkonte përgjegjësi ose llogari nga kompania për mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale por pavarësisht informimit nuk ishte marrë asnjë masë, duke vënë në pah kështu edhe njëherë qëllimin e të pandehurve për t'ia mundësuar përfitimin kompanive në fjalë. Kjo për faktin se në raport me këto provat dhe vlerësim të këtyre dëshmive të dëshmitarëve gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsyet të qarta, për të cilat pajtohet edhe kjo gjykatë, pasi që si është cekur edhe më lartë në këtë aktgjykim, gjykata e shkallës së parë pas analizimit dhe vlerësimit të këtyre provave ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë që në veprimet e të akuzuarve, veç e veç, përmbushen elementet e veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par. 1 të KPRK-së gjegjësisht elementi subjektiv-dashja direkte si formë e fajësisë e cila kërkohet që të provohet për kryesit të kësaj veprë penale, prandaj vetëm fakti i pretenduar nga prokuroria si në ankesë për mos ndërmarrjen e masave nga ana e të pandehurës pa ndonjë provë konkrete të ndërlidhur për të vërtetuar dashjen direkte e të akuzuarve nuk vërteton përtej dyshimit të bazuar qëllimin për përfitim për personat tjerë si pretendon prokuroria në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet ankimore se shkeljet e gjykatës së shkallës së parë vërtetohen edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 21.12.2022 në të cilin prokurori i kësaj çështje kishte theksuar se nuk do ta nënshkruante procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor paraprak atë të datës 12.12.2022 me arsyetimin se ai procesverbal kishte gabime në konstatimin e profesionit të ekspertit dhe në konstatimin e pyetjeve edhe përgjigjeve që i parashtroheshin atij të meta këto që sado që mund të *supozohet* se ishin të karakterit teknik apo drejtshkrimor, ngjallin frikën se gabime të tilla mund të jenë lëshuar edhe në pjesë tjera të procesverbaleve të cilat nuk janë evidentuar për shkak se ishin voluminoze dhe ishin dërguar me vonesë - disa ditë pas përfundimit të seancave apo në kundërshtim me dispozitat e KPP-së. Prokuroria pretendon se një gjë e tillë mund të jetë bërë ose duhet të ketë frikë se kjo ka ndodhur për të dëmtuar reputacionin apo kredibilitetin e ekspertit të prokurimit dhe se një veprim i tillë sipas prokurorisë ishte tendencë e mbrojtjes, përkatësisht gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 21.11.2022. Kolegji penal i kësaj gjykate këto pretendim i gjen të pabazuara dhe abstrakte ngase edhe vet prokuroria në ankesën e saj thekson se këto mund të jenë supozuese, ndërsa në anën tjetër në ankesë nuk saktësohet se cilat nga këto lëshime të quajtura si teknike apo drejtshkrimore kishin ndikuar në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, ngase në rrethanat e pretenduara nuk mund të kuptohet drejt se cila dispozitë nuk është zbatuar apo është zbatuar gabimisht nga gjykata për të justifikuar faktin apo frikën e ndikimit të tyre në vendimmarrje të drejtë dhe të ligjshëm nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale përkatësisht nenit 384 par.2 pika 2.1 të KPP-së edhe në rastin kur gabimisht ka ftuar dëshmitarë për të dhënë dëshminë e tyre duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në rrjedhën e procedurës dhe favorizimin e të pandehurve. Kjo pasi që në frymën e kodit të procedurës penale gjyqtari/kryetari i trupit gjykues, konform nenit 295 të KPPK-ës, detyrohen të kujdesen për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe në kuptim të administrimit të shqyrtimit gjyqësor gjykatat në asnjë mënyrë nuk mund të lejojnë që palët dhe pjesëmarrësit të tjerë në procedurë të përcaktojnë dhe udhëheqin radhën apo mënyrën e procedimi të provave dhe dëshmitarëve në një çështje sipas vullnetit dhe dëshirës së tyre në një shqyrtim gjyqësor si pretendon prokuroria në ankesë në raport me dëshmitarin e prokurorisë andaj, në këtë drejtim edhe pretendimi ankimor se në këtë rast është ulur kredibiliteti i gjykatës gjatë konfrontimit të kryetarit të trupit gjykues me dëshmitarin V.J., dhe që sipas pretendimit të prokurorisë nuk mund të pritët që ti falet besimi apo të vlerësohet në mënyrë të drejtë deklarata e dëshmitarit, janë pretendimet e pabazuara ngase nga arsyetim i aktgjykimit të ankimuar nuk rrjedh se gjykata nuk

i fali besimin si pretendon ankesa këtij dëshmitari por në raport me dëshminë e tij, V.J., si rrjedh nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar gjykata kishte dhënë arsytet konkrete duke qenë se pas analizimit dhe vlerësimit e dëshmisë të këtij dëshmitari nga kjo dëshmi nuk ka gjetur për të vërtetuar ndonjë fakt relevant në raport me veprimet e të akuzuarve për veprën penale për të cilën janë akuzuar andaj, ky pretendim nuk gjen mbështetje dhe justifikim për mos pritshmërinë e besueshmërisë apo jo të dëshmisë së këtij dëshmitari, ngase gjykata në këtë çështje penale kishte analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat një nga një, në kuptim të nenit 360 të KPP-së, duke ardhur në përfundim se për të liruar nga akuza të akuzuarit për veprën penale për të cilën janë akuzuar ngase nuk është provuar se në veprimet e tyre përmbushen elementet e veprës penale të Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 (të ndërlidhur me par.1) të KPP-së.

Gjykata e Apelit rikujton se kodi i procedurës penale në nenit 9 (kapitulli I, parimet themelore) garanton barazinë e palëve në procedurë penale ku të pandehurin dhe prokurorin e shtetit i vë në pozitë të barabartë procedurale, prandaj në drejtim të pretendimit ankimore se gjykata duke e shtyrë kështu seancën për datën 21.12.2022 duke i mundësuar kështu mbrojtjes përgatitjen për marrjen e tërthortë në pyetje të ekspertit, është pretendim i pabazuar dhe si i tillë në kundërshtim edhe me parimet themelore të kodit të procedurës penale gjegjësisht nenit 11 të KPP-së (përshtatshmëria e mbrojtjes), ku të pandehurit dhe rrjedhimisht mbrojtjes së tij i garantohet e drejta në kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij andaj, në kuptim të garantimit për një proces të drejtë dhe të rregullt, nën supozimin se mbrojtja do të kërkonte kohë për përgatitjen e mbrojtjes së saj, si pretendon prokuroria për marrjen e tërthortë në pyetje të ekspertit, do të ishte krejtësisht ligjore edhe pranimi i një kërkesë të tillë (të mundshme) të paraqitur me qëllim të respektimit të të drejtave të palëve në procedurë për një proces të drejtë dhe të rregullte, ashtu si parasheh kodi i procedurës penale në parimet themelore të tij.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin e prokurorisë se gjykata ka zbatuar gabimisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për faktin se seancat i ka caktuar gabimisht apo në lloj difference kohore prej rreth 60 ditësh duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 310 të KPP-së, duke ndikuar kështu në efikasitetin e gjykimit. Kjo për fakt se, përveç se si është theksuar edhe më lartë se, gjyqtari/kryetari i trupit gjykues detyrohen të kujdesen për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe në kuptim të administrimit të shqyrtimit gjyqësore, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e kodit të procedurës penale e rrjedhimisht as me nenin 310 të KPP-së, ngase çështja e shtyrjes së shqyrtimeve gjyqësore me

kodin e procedurës penale është e rregulluar dhe në kuptim të obligimeve të gjykatës në ato raste (*pra nëse shtyrja do të ishte më shumë se 3 muaj, zëvendësohej anëtar-kryetar i trupit gjykues*), e në veçanti nëse shtyrja ka zgjatur për më shumë se 3 muaj, gjë që në këtë rast, si thekson prokuroria *se seancat i ka caktuar gabimisht apo në lloj diference kohore prej rreth 60 ditësh*, rrjedh se gjykata nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe me këtë të ketë bërë, si pretendon prokuroria, shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptimin e efikasitetit të gjykimit, pasi që gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale përgjatë zbatimit të shqyrtimit gjyqësor ka zbatuar drejtë dispozitat e kodit të procedurës penale e të cilat si rrjedhojë e saj edhe kanë ndikuar në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm nga gjykata, e në rastin konkretë aktgjykimin e ankimuar në këtë çështje penale.

Përkitazi me pretendimin ankimor se gjykata e shkallës së parë nuk ishte objektive dhe që anshmëria e gjykatës dëshmohej edhe nga mënyra e trajtimit apo interpretimit të provave dhe deklaratave të dëshmitarëve të përshkruara në aktgjykim duke ia humbur thelbin deklaratës dhe duke e interpretuar atë në favor e të pandehurve, pasi që të njëjtat duket se janë përshkruar në atë mënyrë që të krijojnë përshtypjen se dëshmitarët nuk kanë deklaruar asnjë veprim inkriminues për të pandehurit, kolegji i kësaj gjykata gjen se ky pretendim është i pabazuar dhe si i tillë nuk qëndron. Kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka analizuar të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe rrjedhimisht edhe deklaratën e dëshmitarit O.B., duke vepruar kështu konform obligimeve ligjore nga dispozita e neni 360 par.1 dhe 2 të KPP-së, ku në par.2 parasheh dhe obligon që “gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar” andaj duke qenë se gjykata ka dhënë arsyet e qarta për të gjitha pikat e saj duke konstatuar me qartësi dhe arsyeshmëri për fakte e vërtetuar dhe ato të pa provuar, si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, për të cilën përfundim pajtohet edhe kjo Gjykatë si përfundim të drejtë dhe ligjor pasi që në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë, objektive dhe të qartë kishte analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar çdo provë të administruar në shqyrtim gjyqësor të kësaj çështje penale.

Për më tepër kolegji i kësaj Gjykate përkitazi me këtë pretendim, e që prokuroria pretendon se nga dëshmia e dëshmitarit, O.B., dëshmon dashjen e të pandehurit për t’ia mundësuar përfitimin kompanive me të cilat kishin lidhur kontratat *sepse nëse* do të bëhej hulumtimi i tregut do të kuptohej çmimi i rregullt, numri i kompanive që ofrojnë shërbimet e kërkuara, e vlerëson si një dëshmi e cila, përveç opinionit të tij supozues pra me bindjen e tij se nëse do të hulumtohej tregu,

nuk vërteton ndonjë fakt relevant për qëllimin dhe dashjen e të pandehurve si pretendon prokuroria ngase ashtu si ka ardhur në përfundim edhe gjykata e shkallës së parë, nga tërësia e provave të administruar në shqyrtim gjyqësor, edhe kjo Gjykatë gjen se, duke vlerësuar edhe këtë dëshmi edhe nga provat tjera nuk vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kishin për qëllim dhe dashjen që duke keqpërdor detyrën zyrtare e duke i tejkaluar kompetencat e tyre të sjellin personit tjetër dobi pasurore ngase nga provat si në shkresat e kësaj çështje nuk rezulton për të vërtetuar me siguri të plotë se të akuzuarit me veprimet të tyre kishin qëllimin për të mundësuar përfitim të dobisë pasurore personit tjetër këto OE “M..... P.. & E.....” dhe “M..... G..... S..... LLC”, si pretendon prokuroria në këtë çështje penale.

Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimin ankimor të prokurorisë se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe me këtë edhe shkeljen e ligjit penal ku gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur provat e paraqitur nga prokuroria duke analizuar vetëm dy provat dhe atë; opinionin e KRPP-së dhe ekspertizën e A.Sh., se ka anashkaluar në veçanti kërkesën e parashtruar nga e pandehura Dh.H. nr.prot. prot.01/8731-2018 dt. 11.05.2018, për të pandehurin D.Sh., kërkesën e parashtruar nga e pandehura Dh.H., me nr. prot.01/257-1-2019 dt. 21.02.2019, për të pandehurin K.C., ku ngjashëm e njëjta kërkon që sipas procedurave të sipër cekura t'i vazhdohet kontrata kompanisë " M..... P.. & E.....", si dhe kërkesën e parashtruar po ashtu nga e pandehura Dh.H. me nr. prot. 667-1-2019, datë 24.04.2019, për të pandehurin K.C., ku ngjashëm e njëjta kërkon që të lidhet kontratë me kompaninë "M..... G.....", se nuk ka analizuar asnjërën nga këto konstatimet e ekspertit si në faqe 12 par.1, konstatimin e ekspertit si në paragrafin 4 të faqes 12, deklaratën e ekspertit në shqyrtim gjyqësor si në faqen 78 të procesverbalit, pjesën e deklaratës së ekspertit si në faqen 93 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 21.12.2022, përgjigjen e ekspertit si në faqen 94 të të njëjtit procesverbal, se nuk e ka analizuar as deklaratën e dëshmitarit N.N. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor si në procesverbalin e datës 17.06.2023, faqe 32 dhe 33, deklaratën e të pandehurit K.C. si dhe provat tjera materiale nga të cilat sipas prokurorisë vërtetohet se Ministria e Integritetit Evropian, pas përfundimit të mandatit të të pandehurës Dh.H., me urdhëresë të saj kishte shkëputur kontrata në mënyrë të njëanshme me kompaninë "M..... G.....", nuk e ka vlerësuar as provën siç është “Opinionin e Departamentit të Drejtësisë të BE-së”, e as kontratën me titull "Shërbime të konsulencës ndërkombëtare për nevojat e MIE-së", se gjykata në arsyetimin e saj gabimisht i është referuar edhe opinionit të KRPP-së, duke theksuar se sipas këtij opinionit KRPP i kishte dhënë "shumë diskrecion AK-së që të vendos lidhur me procedurën e cila do të zgjidhet", se me rastin e vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve V.H., B.V.C., V.H.



dhe V.J., nuk i ka kuptuar relevancën e tyre ose të njëjtat i ka interpretuar në favor drejtpërdrejt të të pandehurve, pasi që këto dëshmi drejtpërdrejt vërtetojnë që këto kontrata të lidhura në mes të Ministrisë së Integritimit Evropian me kompanitë " M..... P.. & E....." dhe "M..... G.....", nuk janë implementuar ashtu sikurse parashihej në kushtet e kontratës, nuk e ka analizuar tejkalimin e kompetencës në aspektin gjeografik nga Ministria e Integritimit Evropian me rastin e hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me një kompani nga ShBA-ja, pasi që MIE nuk kishte kompetenca territoriale jashtë territorit të vendeve të Bashkimit Evropian, në arsyetimin e saj gabimisht ka konstatuar se nuk është vërtetuar qëllimi kriminal i të pandehurve për kryerjen e veprës penale dhe se një rrethanë e tillë që vërteton dashjen e të pandehurve veçanërisht janë opinionet që i janë dhënë të pandehurve në veçanti ai i Departamentit të Drejtësisë të BE-së, dt. 25.05.2018 i cili qartazi ia kishte sqaruar të pandehurve kompetencat e tyre personale si bartës të funksioneve, kompetencat e Ministrisë së Integritimit Evropian, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Zyrës së Kryeministrit, si dhe iu kishte rekomanduar procedura tjera alternative më transparente për t'i aplikuar, të cilat të pandehurit i injoruan, këto pretendimet kolegjive të kësaj gjykate i gjen të pabazuar për faktin se nga arsyetimi i aktgjyqimit të ankimuar rrjedh se të gjitha këto provat gjykata i kishte analizuar dhe vlerësuar konform obligimeve ligjore të dispozitës së nenit 360 par.1 dhe 2 të KPP-së, për të cilat ka dhënë arsyet të qarta dhe konkrete për faktet dhe rrethanat e pretenduara nga prokuroria duke ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk janë provuar faktet konkrete të cilat përbëjnë elementet kryesore të figurës së veprës penale për të cilën janë akuzuar.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe përkitazi me këtë ka dhënë arsyet të qarta dhe konkrete në aktgjykimin e ankimuar, duke gjetur me të drejtë se me provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj edhe kolegjive penal i kësaj gjykate pajtohet me përfundim të gjykata e shkallës së parë, duke nxjerr aktgjykimin lirues në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, duke i liruar të akuzuarit nga akuza e PSRK-së për veprat penale për të cilat i ka akuzuar.

Gjykata e Apelit ndan të njëjtën pikëpamje me gjykatën e shkallës së parë meqenëse në këtë çështje penale nga provat e administruara nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën janë ngarkuar, gjegjësisht nga këto prova nuk është arritur që të vërtetohen elementet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale e në

veçanti elementi subjektiv-dashja direkte e të akuzuarve, e cila kërkohet që domosdoshmërisht të vërtetohet për tu konsideruar se kryesit kanë kryer këtë vepër penale.

Si rezulton nga gjendja e fakteve të konstatuar në këtë çështje penale, nuk ishte kontestuese ndërmarrja e veprimeve nga ana e të akuzuarve, pra kërkesat dhe aprovimet e tyre nga të akuzuarit, për të cilat prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i kishte vlerësuar dhe analizuar drejtë, në veçanti kërkesat me shkrim nga e akuzuara Dh.H. drejtuar të akuzuarve tjerë për të zbatuar dhe përfunduar procedurat e prokurimit për aktivitetin “ shërbimet të konsulencës për nevojat e MIE” dhe nënshkrimin e kontratave me operator “M..... P.. & E.....” dhe “M..... G.....”, si dhe vlerësimin e mendimeve dhe opinioneve, pasi që kjo rrjedh dhe konstatohet nga provat shkresore në këtë çështje penale, por a provohej me këto prova përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kishin kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, pra e pandehura Dh.H. duke i tejkalluar kompetencat e saj si ministre e MIE, ndërsa të pandehurit F.M. , D.Sh., K.C. dhe N.O. duke e shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare, që sipas akuzës ishin me qëllim që operatoreve në fjalë të mundësojnë përfitim të pasuror, ky element subjektiv-dashja direkte( si forma e fajit) për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 ( që ndërlidhet me par.1) të KPK-ës, nga rrethanat e fakteve të konstatuara nga këto provat nuk është arritur që të vërtetohej përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kishin dashjen dhe qëllimin që ti mundësojnë përfitim të dobisë pasurore personave tjerë-operatorëve ekonomik në fjalë, si është pretenduar me aktakuzë dhe tani me pretendimet ankimore.

Është e qartë se në këtë çështje penale thelbi i akuzë për të cilën pretendon prokuroria në ngarkim të veprës penale dhe përgjegjësisë penale për të akuzuarën Dh.H. është për tejkallim të kompetencave ligjore të saj si ministre e MIE për shkak të parashtrimit të kërkesave për iniciimin e procedurave të prokurimit, përcaktimin e llojit dhe arsyeshmërin e procedurës së prokurimit që duhej aplikuar dhe përcaktimin e operatorëve ekonomik me të cilët duhej hyrë në negociata, (*procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë një burimore*) ndërsa për të akuzuarit tjerë, F.M., D.Sh., K.C. dhe N.O. për shkak të shfrytëzimit të detyrës së tyre zyrtare duke i aprovuar këto kërkesa të paraqitura nga e akuzuara Dh.H., dhe në këtë mënyrë i hapin rrugë për nënshkrimin e kontratave me këta operator ekonomik, dhe me këto veprimet e të akuzuarve është mundësuar përfitim për personin tjetër gjegjësisht për operatorët “M..... P.. & E.....” dhe “M..... G.....” për shumat monetare të përcaktuara si në përshkrim faktik të akuzues, ku sipas prokurorisë edhe përkundër se po të konstatohej se eventualisht ishin plotësuar kushtet për aplikim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të paraparë në nenin 35 par.2 të

LPP, kjo prapë se prapë nuk do ti amnistonte të pandehurit të tjerët pasi që neni 35 nuk i jep kompetencë ministres inicimin e kërkesave për këtë procedurë.

Mirëpo, për këto pretendime, si me të drejtë ka ardhur në përfundim gjykata e shkallë së parë me aktgjykimin e ankimuar duke dhënë arsyet të qarta dhe konkrete, si në fq.29 pasuesi II, me të cilën qëndrim pajtohet edhe kjo Gjykatë, rrjedh se meqenëse LPP-ja nuk përmban ndonjë dispozitë që i jep tagër ndonjë autoriteti për inicim të një procedure të tillë (për nevojat e konsulecës) dhe shpjegon se cila është njësia kërkuese në kuadër të këtij autoritetit kontraktues, ku në rastin konkretë ishte paraqitur ministrja, e pandehura Dh.H., bazuar në natyrën e shërbimeve që kërkohet, dhe si me të drejtë ka konkluduar gjykata e shkallë së parë në bazë të parimit *“është e lejuar ajo e cila nuk është e ndaluar”*, meqenëse konsulenca është sfera e veçantë dhe ky lloj prokurimi ishte i veçantë, rrjedh se në këtë rast nuk mund të vërtetohet se e akuzuara Dh.H. kishte tejkaluar kompetencat e saj për qëllimet të mundësimin të përfitimit të dobisë pasurore tjetrit gjegjësisht OE *“M..... P.. & E.....”* dhe *“M..... G..... S..... LLC”*. Është e qartë se, në këtë rast kërkesa për inicim të procedurës së prokurimit, e cila ishte iniciuar nga e akuzuara Dh.H., si ministre e MIE, i është nënshtruar hapave ligjore të paraparë sipas LPP-së fillimisht drejtuar nëpërmjet Drejtorisë së Divizionit të Prokurimit e cila më pas kishte paraqitur kërkesë Sekretarit të përgjithshëm të MIE për aprovimin e tyre, andaj kjo kërkesë edhe përkundër pretendim se ishte paraqitur nga e pandehura si jo kompetente nëpërmjet mënyrës së procedimit është validuar ligjërisht në kuptim të rregullave të LPP-së, andaj në mungesë të ndonjë prove tjetër konkrete e cila kishte për të dëshmuar se e pandehura këtë kërkesë e kishte paraqitur me qëllimet si pretendon prokuroria rrjedh se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë faktet vendimtare të kësaj çështje penale duke ardhur në përfundim të drejtë se në veprimet e të akuzuarve nuk përmbushen elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar, ngase vetëm fakti i pretenduar nga prokuroria se në këtë rast për shkak të mos përmbushjes (kualitative) të kontratës nga OE *“M..... P.. & E.....”* nuk provon qëllimin kriminal dhe dashjen direkte e të akuzuarve për kryerjen e veprës penale për të cilën janë akuzuar, kjo edhe për faktin se nga dëshmitë e dëshmitareve në këtë çështje penale nuk rezulton në asnjë rrethanë se të akuzuarit në këtë çështje penale në ndonjë formë apo mënyrë ishin drejtuar në drejtim të tyre me qëllim të ndikimit apo ndërhyrjes në punët e tyre si anëtarë të komisioneve, përkundër ata kanë dëshmuar se gjatë punës së tyre nuk kanë pas asnjë presion apo ndërhyrje nga ndonjë zyrtarë, andaj rrjedh se i gjithë procesi përkitazi me këto kontrata ishte ligjor dhe të zbatuar nga zyrtarë-anëtarë kompetent në këto komisionet përkatëse, dhe atë nga anëtarët (dëshmitarët në këtë çështje) të komisioneve për negociim të kushteve të këtyre kontratave me

OE e deri tek anëtarë të komisioneve për vlerësim të përmbushjes së shërbimeve të ofruara nga këto OE.

Pra, si me të drejtë kishte dhënë arsyet gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, fq.28, në veprimet e të akuzuarës Dh.H. nuk është vërtetuar tejkalimi i kompetencave ngase në bazë të detyrave të punës si ministre ishte përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave qeveritare në fushën e saj të përgjegjësisë, andaj vlerësuar këtë si veprim- kërkesë për inicim të procedurës së prokurimit si në këtë çështje penale e në mungesë të provave tjera të cilët kishin për të vërtetuar qëllimin dhe dashjen e të pandehurve për kryerjen e veprës penale për të cilën janë akuzuar rrjedh se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar me të drejtë kishte ardhur në përfundim duke i liruar nga akuza të akuzuarit e kësaj çështje penale ngase nuk është vërtetuar se të akuzuarit kishin kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Gjykata e Apelit gjen se në këtë çështje penale, ashtu si me të drejtë kishte ardhur në përfundim gjykata e shkallës së parë në raport me të akuzuarit, F.M., D.Sh., K.C. dhe N.O., si pretendon prokuroria për shfrytëzim të detyrës së tyre zyrtare duke i aprovuar këto kërkesa të paraqitura nga e akuzuara Dh.H., si në aktgjykimin e ankimuar në fq.28, kishte dhënë edhe arsyet të qarta dhe konkrete, se nga provat të administruara nuk është vërtetuar asnjë nga rrethanë për qëllim të keqpërdorimit të detyrës së tyre zyrtare për ti mundësuar përfitim pasuror OE të pretenduar si në aktakuzë, përkundë kësaj të gjithë të akuzuarit në kuadër të kompetencave të tyre ligjore dhe sipas detyrave të punës kishin kryer veprimet konform dispozitave ligjore në fuqi. Për më tepër nga këto provat ishte vërtetuar se para ndërmarrjes së veprimeve për procedurë të prokurimit sipas kërkesës së të pandehurës Dh.H. drejtuar këtu të pandehurit D.Sh., në cilësi të sekretarit të përgjithshëm të MIE, i njëjti ishte drejtuar pos autoriteteve tjerë dhe Komisionit për Rregulativ dhe Prokurim Publik (KRPP) për marrje të opinionit në të cilin opinion dëshmitari, Osman Bytyqi, kishte dhënë shpjegime, ku veç tjerash, sa i përket aplikimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka sqaruar se konform LPP-së, kjo ishte në diskrecion të AK se cilën procedurë do të aplikojnë.

Gjykata e Apelit rithekson se, ashtu si kishte arsyetuar edhe gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, për tu konsideruar se kryesi ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së duhet të vërtetohet edhe elementi-subjektiv (dashjen direkte), i cili element nxirret nga rrethanat e fakteve, konform nenit 22 të KPK-së, e cila dispozitë përcakton se “*dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si*

*element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike*” prandaj meqenëse në këtë çështje penale nga provat e administruara nuk është provuar ky element i figurës së kësaj vepre penale gjegjësisht qëllimi i të gjithë të akuzuarve për të kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit dhe në këtë mënyrë ti mundësojnë përfitim pasuror operatorëve M..... P.. & E....." dhe "M..... G..... S..... LLC" “për shërbimet e konsulencës MIE”, edhe pse të akuzuarit, në njërën anë, ishin akuzuar secili veç e veç për veprimet e tyre në shkelje të veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 77 par.1 të KPK-së (në formën e kryerjes tejkalim të kompetencave dhe shfrytëzim të detyrave të tyre zyrtare) ndërsa në anën tjetër kishin një qëllim të përbashkët, pra mundësimin e përfitimit të dobisë pasurore operatorëve ekonomik të cekur si më lartë, e që në këtë pikë edhe kjo Gjykatë pajtohet me përfundimin e gjykata e shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar rrjedh se me provat e administruara nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve fitohen elementet e veprës penale e në veçanti elementi subjekti- dashja direkte e të akuzuarve për realizimin e këtij qëllimi të njëjtë, si pretendon prokuroria.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimor se në këtë çështje penale, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është shkel edhe ligji penal nga gjykata e shkallës së parë, kjo për faktin se, meqenëse në këtë çështje penale gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë rezulton se nuk ka as shkelje të ligjit penal pasi që, ashtu si me të drejtë dhe në mënyrë të qartë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka dhënë arsyet për faktet vendimtare në këtë çështje penale, dhe se në rastin konkretë nuk është vërtetuar me provat e administruara përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nuk rezulton as pretendimi ankimor që të jetë i bazuar në këtë drejtim.

Andaj, duke pasur parasysh gjendjen e fakteve të vërtetuar në shqyrtimin gjyqësor dhe ky kolegji penal është bindur se gjykata e shkallës së parë arriti në përfundimin e drejtë, se nga provat e administruara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit në bashkëkryerje të kenë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, të akuzuarit i ka liruar nga akuzua meqenëse nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**APS.nr.38/2023, datë: 08.04.2024**

**Bashkëpunëtoe Profesionale,**

**Anëtarët e kolegjit,**

**Kryetar i kolegjit,**

---

**Fitore Batatina**

---

**Vaton Durguti**

---

**Ferit Osmani**

---

**Afërdita Bytyçi**